

PHILIPS

Kufjet

Seria **4000**

TAA4216



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria e dëgjimit	2
	Informacione të përgjithshme	2
<hr/>		
2	Kufjet tuaja me Bluetooth	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisje të tjera	3
	Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth	4
<hr/>		
3	Fillimi	5
	Karikimi i baterisë	5
	Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular	5
<hr/>		
4	Përdorimi i kufjeve	6
	Lidhni kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth	6
	Menaxhoni telefonatat dhe muzikën	6
	Pastrojeni dhe ndërrojeni vatën	7
<hr/>		
5	Të dhëna teknike	8
<hr/>		
6	Njoftim	9
	Deklarata e pajtueshmërisë	9
	Hedhja e produktit dhe e baterisë së vjetër	9
	Hiqni baterinë e brendshme	9
	Pajtueshmëria me EMF	9
	Informacione mjedisore	10
	Njoftimi për pajtueshmërinë	10
<hr/>		
7	Markat tregtare	11
<hr/>		
8	Pyetjet më të shpeshta	12

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria e dëgjimit



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e të dëgjuarit, kufizoni kohën që përdorni kufjet në vOLUME të larta dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër është koha e dëgjimit të sigurt.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur e përdorni kufjet.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm dhe për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumin ndërsa mësoheni me dëgjimin.
- Mos e ngrini volumin aq shumë sa të mos dëgjoni çfarë ndodh rreth jush.
- Duhet të tregoni kujdes ose duhet të mos i përdorni përkohësisht kufjet në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbjen e dëgjimit.
- Nuk rekomandohet përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar ndërsa drejtoni automjetin, dhe kjo mund të jetë e paligjshme në disa zona kur drejtoni automjetin.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik apo në vende që mund të jenë të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimin ose defektet:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet ndaj nxehtësisë së tepërt
- Mos i hidhni në tokë kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj pikave ose stërkalave.
- Mos i lejoni kufjet të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përbajnë alkool, amoniak, benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim, përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme, me një sasi të ulët uji ose sapun të butë të shkrirë, për të pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Ndërrimi i baterisë me një tip të gabuar mund të jetë i rrezikshëm;
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë të nxehtë, ose shtypja mekanike apo prerja e baterisë, të cilat mund të shkaktojnë shpërthim;
- Lënia e baterisë në një ambient me temperaturë tepër të lartë mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm;
- Nëse bateria është nën presion atmosferik tepër të ulët, kjo mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.
- Asnjëherë mos i përdorni kufjet kur përdorni një mjet motorik, kur ngisni biçikletën, kur vraponi ose kur ecni në zona me qarkullim. Është e rrezikshme dhe e ndaluar në shumë vende.

Lidhur me temperaturat dhe lagështinë gjatë përdorimit dhe ruajtjes

- Temperatura e operimit: 0°C (32°F) deri në 40°C (104°F)
- Temperatura e ruajtjes: -10°C (14°F) deri në 45°C (113°F)
- Lagështia e operimit: 8% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lagështia e ruajtjes: 5% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lartësia maksimale e operimit: 3000m
- Jeta e baterisë mund të jetë më e shkurtër në temperatura të larta ose të ulëta.

2 Kufjet tuaja me Bluetooth



Udhëzues i shkurtër



Garancia botërore



Fletëpalosje sigurie

Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.


Me këto kufje Philips me valë, ju mund:

- të bëni telefonata të rehatshme pa lidhje me tel dhe me duar të lira;
- të dëgjoni dhe kontrolloni muzikë pa lidhje me tel;
- të kaloni mes telefonatave dhe muzikës.

Çfarë ka në kuti



Kufje Philips me valë Bluetooth Philips TAA4216




Kablo karikimi USB-C (vetëm për karikim)

Pajisje të tjera

Një telefon celular ose pajisje (p.sh. notebook, PAD, adaptorë Bluetooth, MP3, etj.) që mbështet Bluetooth dhe që është e pajtueshme me kufjet (shiko "Të dhëna teknike").

Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth



- ① Volumi +
- ② ⏻ (Ndezja / Fikja / Çiftimi)
- ③ Volumi -
- ④ Xheku 3.5mm
- ⑤ Vendi i karikimit USB Type C
- ⑥ Treguesi LED
- ⑦ Mikrofoli

3 Fillimi

Karikimi i baterisë

Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet për herë të parë, vendosini kufjet në kasën e karikimit dhe karikoni baterinë për 3 orë që bateria të ketë kapacitet dhe jetëgjatësi optimale.
- Përdorni vetëm kabllon USB të karikimit origjinale për të shmangur ndonjë dëmtim.
- Mbaroni telefonatën para se të karikoni kufjet, pasi lidhja e kufjeve për karikim do t'i fikë ato.

Lidhni kabllon e dhënë USB të karikimit me:


- portën e karikimit USB Type C në kufjet, dhe;
 - portën e karikimit/USB në një kompjuter.
- ↳ Drita LED ndizet në ngjyrë të bardhë gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet janë të karikuara plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë zgjat 2 orë.

Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular

Para se t'i përdorni kufjet me telefonin për herë të parë, çiftojini me një telefon celular. Një çiftim i suksesshëm krijon një lidhje unike të koduar midis kufjeve dhe telefonit. Kufjet ruajnë në memorie 8 pajisjet e fundit. Nëse përpigëni të çiftoni me shumë se 8 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me të fundit.

- 1 Sigurohuni që kufjet të jenë karikuar plotësisht dhe të jenë të fikura.
- 2 Mbani shtypur  për 6 sekonda derisa drita LED blu dhe e bardhë të pulsojnë me radhë.
 - ↳ Kufjet qëndrojnë në modalitetin e çiftimit për 2 minuta.
- 3 Sigurohuni që celulari të jetë i ndezur dhe që të jetë aktivizuar veçoria Bluetooth.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin celular. Për informacione të detajuara, shikoni manualin e përdorimit të telefonit.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon se si t'i çiftoni kufjet me telefonin celular.

- ↳ Aktivizoni veçorinë Bluetooth të telefonit celular, zgjidhni **Philips TAA4216**



Philips TAA4216

4 Përdorimi i kufjeve

Lidhini kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth

- 1 Ndizni telefon celular/pajisjen Bluetooth.
- 2 Mbani shtypur butonin e ndezjes/fikjes për 2 sekonda për t'i ndezur kufjet.
 - ↳ Drita LED me ngjyrë të bardhë do të ndizet.
 - ↳ Kufjet lidhen automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth të lidhur më së fundi.



Këshillë

- Nëse ndizni telefonin celular/pajisjen Bluetooth ose aktivizoni veçorinë Bluetooth pasi të ndizni kufjet, duhet të rilidhni përsëri manualisht kufjet dhe telefonin celular/pajisjen me Bluetooth.



Shënim

- Nëse kufjet nuk lidhen me pajisjen e fundit të lidhur Bluetooth brenda fushës brenda 1 minute, ato do të kalojnë në modalitetin e çiftimit për 2 minuta, pastaj do të fiken nëse nuk lidhen me asnjë pajisje Bluetooth 5 minuta më vonë.
- Nëse kufjet nuk kanë asnjë histori lidhjeje dhe nuk lidhen me asnjë pajisje me Bluetooth brenda 5 minutash, ato do të fiken automatikisht.

Menaxhoni telefonatat dhe muzikën







Ndezja/Fikja

Detyra	Butoni	Funksionimi
Ndezja e kufjeve.		Mbajeni shtypur për 2 sekonda.
Fikja e kufjeve.		Mbajeni shtypur për 4 sekonda. <ul style="list-style-type: none">↳ Drita LED e bardhë ndizet dhe zbehet.

Kontrolli i muzikës

Detyra	Butoni	Funksionimi
Luani ose ndaloni muzikën.		Shtypeni një herë.
Rregullimi i volumnit.	+/-	Shtypni +/-
Kënga tjetër.	+	Shtypni + dhe mbajeni shtypur 2s
Kënga e mëparshme.	-	Shtypni - dhe mbajeni shtypur 2s

Kontrulli i telefonatës

Detyra	Butoni	Funksionimi
Pranoni/refuzoni një telefonatë.		Shtypeni një herë.
Refuzo një telefonatë		Mbajeni shtypur 2 s
Vendoseni telefonatën aktuale në pritje dhe pranoni një telefonatë hyrëse		Shtypeni një herë
Vendoseni telefonatën aktuale në pritje dhe refuzoni një telefonatë hyrëse		Mbajeni shtypur 2 s
Anuloni telefonatën aktuale dhe pranoni një telefonatë hyrëse		Shtypeni dy herë
Kaloni mes telefonatave		Shtypeni 3 herë

Asistenti me zë


Detyra	Butoni	Funksionimi
Zgjoni asistentin standard me zë	kontrolli i muzikës/ telefonatës	Shtypeni dy herë

Statusi tregues i kufjeve të tjera


Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth, ndërsa kufjet janë në gjendje gatishmërie ose ndërsa po dëgjoni muzikë.	Drita LED blu pulson çdo 4s
Kufjet janë gati për çiftim.	Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë.
Kufjet janë të ndezura por jo të lidhura me një pajisje Bluetooth.	Drita LED blu pulson me ngadalë. Nëse nuk mund të bëhet asnjë lidhje, kufjet do të fiken vetë brenda 5 minutash.
Nivel i ulët i baterisë.	Drita e bardhë LED pulson derisa mbaron energjia
Bateria është karikuar plotësisht.	Drita LED e bardhë është e fikur.

Pastrojeni dhe ndërrojeni vatën


- 1 Kapeni cepin e kupës së kufjeve dhe nxirreni.




- 2 Nxirrini kupa e ftohjes në shtresën e mesit dhe shpëlajeni kapakun e vatës.



- 3 Vendosini kupa e ftohjes përsëri në kapakun e vatës së kupave.



- 4 Vendoseni anën e vatës te dhëmbi në kufjet, më pas rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës.



5 Të dhëna teknike

kufjet

- Koha e muzikës: 35 orë
- Koha e bisedës: 35 orë
- Koha e karikimit: 2 orë
- Karikim i shpejtë, 15 minuta karikim për të dëgjuar 2 orë
- Bateria e karikueshme me polimere litiumi (350 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5.0
- Profilet e pajtueshme Bluetooth:
 - HFP (Hands-Free Profile)
 - A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)
 - AVRCP (Audio Video Remote Control Profile)
- Audio codec që mbështetet: SBC
- Rrezja e frekuencave: 2.402-2.480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Gama e funksionimit: Deri në 10 metra
- Telefonata me zë të qartë me reduktim të ekos dhe zhurmës dixhitale
- Fije automatike e rrymës
- Portë karikimi USB Type-C
- Paralajmërim për bateri të ulët: disponohet

Shënim

- Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

6 Njoftim

Deklarata e pajtueshmërisë

Me anë të kësaj, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe me dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni Deklaratën e Pajtueshmërisë në www.p4c.philips.com.

Hedhja e produktit dhe e baterisë së vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të karikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU, e cila nuk mund të hidhet bashkë me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin në një pikë zrytare grumbullimi ose në një qendër servisi Philips në mënyrë që bateria e karikueshme të hiqet nga një profesionist. Informohuni në lidhje me sistemin e veçantë lokal për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive të karikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e karikueshme bashkë me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Hiqni baterinë e brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produkte elektronike, mund ta mbronj mjedisin duke e hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë të shkëputura nga kasa e karikimit para se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt përputhet me të gjitha standardet dhe rregulloret përkatëse në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shkumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shkumës mbrojtëse.)

Sistemi përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi të respektoni rregulloret vendëse në lidhje me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftimi për pajtueshmërinë

Pajisja përputhet me rregullat FCC, pika 15. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshiruar.

Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se u përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasës B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë caktuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient rezidencial. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencës radio dhe, nëse nuk është instaluar dhe përdorur në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila

mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Ndryshoni drejtimin ose vendin e antenës.
- Largojeni pajisjen nga marrësi
- Lidhni pajisjen në një dalje në një qark të ndryshme nga ajo në të cilin është lidhur marrësi.
- Flisni me shitësin ose me një teknik radioje/televizori, i cili ka eksperiencë.

Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Pajisja përputhet me kufijtë e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit të parashikuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk mund të vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

Kujdes: Përdoruesit i tërhiqet vëmendja se ndryshimet ose modifikimet e pamiratuara shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës pa licencë që përputhen me RSS-në pa licencë të Kanadasë për inovacionin, shkencën dhe zhvillimin ekonomik. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshirueshëm të pajisjes.

CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Deklarata IC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Pajisja përputhet me kufijtë Kanadasë për ekspozimin ndaj rrezatimit, që janë përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk mund të vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

7 Markat tregtare

Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara, të cilat zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc., dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Top Victory Investment Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

8 Pyetjet më të shpeshta

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.

Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk i çiftoj dot kufjet e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.

Bluetooth është çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizni kufjet.

Si ta fshini çiftimin.

Rivendosni parametrat e kufjeve duke mbajtur shtypur për 5 sek. butonin e volumnit + dhe të volumnit - së bashku ndërsa kufjet janë të ndezura. Drita blu dhe e bardhë pulsojnë me radhë në modalitetin e çiftimit pasi rivendosja të ketë mbaruar.

Dëgjoj por nuk e kontrolloj dot muzikën në pajisjen time me Bluetooth (p.sh. luaj/ndalo/kalo përpara/mbrapa).

Sigurohuni që burimi audio i Bluetooth mbështet AVRCP (shiko "Të dhëna teknike").

Niveli i volumnit të kufjeve është shumë i ulët.

Disa pajisje me Bluetooth nuk e lidhin dot nivelin e volumnit me kufjet me anë të sinkronizimit të volumnit. Në këtë rast duhet të rregulloni veçmas volumnin në pajisjen tuaj me Bluetooth që ta çoni volumnin në nivelin që doni.

Pajisja me Bluetooth nuk i gjen dot kufjet.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje që janë çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojini jashtë rrezes.
- Çiftimi mund të jetë rivendosur ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftoni sërish kufjet me pajisjen Bluetooth përkthuhet në manualin e përdorimit. (shiko "Çiftimi i kufjeve me pajisjet me Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

Kufjet e mia me Bluetooth janë të lidhura me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e telefonit celular.

Shikoni manualin e përdorimit të telefonit celular. Zgjidhni të dëgjoni muzikë nëpërmjet kufjeve.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet zhurmë e çjerrë.

- Pajisja me Bluetooth është jashtë rrezes. Reduktioni distancën midis kufjeve dhe pajisjeve Bluetooth, ose hiqni pengesat midis tyre.
- Karikoni kufjet.

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

UM_TAA4216_00_SQ_V1.0

